



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Drejtuar: Operatorit ekonomik «Alstezo» shpk**  
Adresa: Lagja Kryengritja, Fier

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Procedura e prokurimit e zgjedhur në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Neni 35/1, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, Neni 33; si dhe Kreut V, Neni 45, pika 1, rekomandimit Nr. 13566 Prot dt 06.11.2017 nga Agjensia e Prokurimit Publik dhe udhëzimit Nr. 6 dt 16.01.2018 për ”Përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, rekomandimit Nr.9941 prot dt 08.11.2018 nga APP ”Mbi shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2019” është **“Procedurë e hapur/Marrëveshje kuadër”**.

Referenca e Procedures se prokurimit: **REF-46992-12-30-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit të Bashkisë Tiranë”**, per ofrimin e shërbimit për mirembajtjen e mjeteve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Fondi limit: **60.000.000 (gjashtëdhjetë milion) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr. 159, datë 21.12.2018, për “Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **29.01.2020, ora 12.30**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 53 datë 31 Dhjetor 2019

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Alstezo” shpk** **NUIS- J63208420N**

Vlera e ofertës pa TVSH është **53.099.080 (pesëdhjetë e tre milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë.**

**2. Operatori ekonomik “Kadiu” sha** **NUIS J61817045K**

Vlera e ofertës pa TVSH është **53.807. 350 (pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.**

**3. Operatori ekonomik “Besnik Meçi” pf** **NUIS L12407012R**

Vlera e ofertës pa TVSH është **46.409.640 (dyzet e gjashtë milion e katërqind e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë.**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm

**1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Besnik Meçi” pf**

Për arsyet si më poshtë vijon:

**1. Operatori ekonomik “Besnik Meçi”Pf nuk plotëson kriterin, pika 3.3 Kapaciteti teknik: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Shërbime te ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 24.000.000 (njëzet e katër milion) lekë pa tvsh, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit.**

OE “Besnik Meçi”Pf ka paraqitur kontrata për shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën 15.404.300 lekë pa tvsh, dhe kontratat e tjera të paraqitura nga OE “**Besnik Meçi”Pf nuk përputhen me objektin e prokurimit, konkretisht:**

- Kontrata me Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, lidhur më datë 2.5.2017 me Objekt ”Blerje pjesë këmbimi”, nuk përputhet me objektin e prokurimit të AK Bashkia Tiranë për shërbime mirëmbajtje mjetesh.
- Kontrata me Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, lidhur më datë 01.04.2019 me Objekt ”Blerje pjesë këmbimi”, nuk përputhet me objektin e prokurimit të AK Bashkia Tiranë për shërbime mirëmbajtje mjetesh.

- Kontrata me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Korçë, lidhur më datë 17.07.2017 me Objekt "Pjesë këmbimi goma dhe bateri", nuk përputhet me objektin e prokurimit të AK Bashkia Tiranë për shërbime mirëmbajtje mjetesh.
- Kontrata me UK Shkodër, lidhur më datë 20.12.2019 me Objekt "Blerje vaj dhe pjesë këmbimi për automjete", nuk përputhet me objektin e prokurimit të AK Bashkia Tiranë për shërbime mirëmbajtje mjetesh.

**2. Operatori ekonomik "Besnik Meçi" Pf Pf nuk plotëson kriterin Kapaciteti teknik:** pika 8/b, *Çertifikatë ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) mbi "Sistemet e menaxhimit të mjedisit", lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.*

KVO konstatoi që çertifikata ISO 14001:2015 e paraqitur nga Operatori ekonomik "Besnik Meçi" Pf, është e skaduar prej datës 15.10.2019.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar **si operator ekonomik i suksesshëm:**

**1. Operatori ekonomik "Alstezo" shpk**

**NUIS- J63208420N**

Vlera e ofertës pa TVSH është **53.099.080 (pesëdhjetë e tre milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë.**

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.01.2020.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar), prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim.